



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**NJOFTIM**  
**“PËR ÇELJEN E GARËS PËR DHËNIEN E 1 (NJË) LICENCE TRANSMETIMI**  
**AUDIO ANALOGE”**

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënie e licencës së transmetimit audio analoge”, miratuar me vendim nr. 7, datë 21.02.2023 të AMA-s, si dhe vendimit nr. 46, datë 07.05.2024 të AMA-s, “Për çeljen e garës për dhënie e licencave të transmetimit audio analoge”, do të organizojë procedurën e përzgjedhjes së kandidaturave për dhënie e 1 (një) licence transmetimi audio analoge, të përbërë nga:

- licenca e shërbimit të programi audio;
- licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit analog.

Për zonat e mëposhtme:

Nr.	Zona e ofrimit të shërbimit	Pika transmetuese	Frekuenca (MHz)
1.	Qarku Lezhë	Tyrbe Lezhë	101
		Lurth	103.6
2.	Qarku Shkodër	Midë	88.5
		Tarabosh	95.5
3.	Qarku Kukës	Tragtan	102.5
		Qafë Prush	107.2

Subjektet e interesuara për t’u pajisur me licencë transmetimi audio analoge, janë të lutur që të depozitojnë aplikimet në Autoritetin e Mediave Audiovizive, Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 15, Kutia Postare 1010, Tiranë, **brenda datës 17.06.2024, ora 10:00.**

Dokumentacioni i plotë i konkurrimit të kandidaturave, që përfshin:

- Rregulloren “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio analoge”, e ndryshuar;
- Kërkesat që duhet të plotësojë aplikimi;
- Kriteret teknike për ofrimin e shërbimit audio përfshirë frekuencën/frekuencat dhe pikën/pikat e transmetimit për zonën e shërbimit;
- Pagesat për licencën, tarifat përkatëse dhe mënyrën e pagesës së tyre.

mund të tërhiqet në zyrën e Arkivë-Protokollit, në AMA, pas kryerjes së pagesës në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve, nga çdo subjekt që synon të marrë pjesë në konkurrim.

Aplikimet do të hapen *në datë 17.06.2024, ora 10:00, në mjediset e AMA-s*, ku subjektet aplikues apo përfaqësuesit e autorizuar prej tyre, kanë të drejtë të jenë të pranishëm në momentin e hapjes së dosjeve të aplikimit.